



**ME EMRIN E ALL-LLAHUT, MËSHIRUESIT, MËSHIRËBËRËSIT!**

Falënderimi i takon Allahut, *subhanehu ve teala*, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi Pejgamberin, *salallahu alejhi ve selem*, dhe pastaj...

Me të vërtetë namazi është pranvera e zemrës së besimtarit, kënaqësia dhe rehatia e tij shpirtërore dhe lidhja mes tij dhe Krijuesit (të tij), ai është mbështetje kur të ashpërsohen çështjet dhe me praktikimin e tij bëhet i qetësuar dhe i lumtur, e s'ka dyshim se kjo është kështu!

Kur Pejgamberit, *salallahu alejhi ve selem*, do t'i ngushtohet ndonjë çështje falej, siç transmetojnë Imam Ahmedi dhe Ebu Davudi, ndërsa shejh Albani ka thënë së ky transmetim është hadith *hasen* (i mirë), të cilin e përcjell Ebu Hurejra, *radijallahu anhu*, për atë se ai, *salallahu alejhi ve selem*, falej kur i ashpërsohet çështja ose e kaplonte mërzia dhe brenga.

E ai, *salallahu alejhi ve selem*, thoshte: "E kam gjetur qetësinë në namaz" (transmetojnë Ahmedi dhe Nesaiu nga hadithi i Enesit, *radijallahu anhu*). Si ka qenë gjendja e tyre në namaz dhe madhështimi i tij po ashtu nga sahabët dhe tabi'inët që janë të njohur për nga e mira dhe *ihsani*, si ka qenë përgatitja e tyre për këtë namaz para se të hyhet në të, e mos të flasim për sjelljen e tyre brenda në të... sepse ata me të vërtetë e kanë kuptuar fuqinë dhe madhështinë e namazit, e në të kanë gjetur qetësinë dhe vetëveten e tyre dhe i kanë kaluar brengat dhe mërzitë e tyre.

Por në sjelljen e atij që sot falet, përveç atë që Allahu e ka mëshiruar, shohim çështje të çuditshme, e ajo është paraqitja e zërave të telefonave celularë

(mobilave) në xhamitë, ndërsa imami nuk mund të merr tekbir për namaz dhe të filloj të lexoj nga Kur'ani famëlartë derisa të qetësohen zërat e zileve dhe ringtoneve nga çdo anë të cilat janë të zëshme si për atë që falet dhe pengon veten nga namazi, por po ashtu i pengon edhe të tjerët nga namazi i tyre, e kjo e mbyl shpirtin dhe koncentrimin në namaz në të cilin duhet të ketë frikërespekt. Duke e ditur se zemrat janë të pakujdesëshme, pyetemi vallë si do të ishte nëse do të shtohet pakujdesia mbi pakujdesi?! Është e çuditshme se mobili cingëron një herë, dy dhe tre herë e ky që falet as që mundohet ta ndërpret atë që i pengon me pretekst se kjo lëvizje do t'ia prish atij namazin, ndërkaq e vërteta është se është vaxhib (e domosdoshme) që ta ndërpres shqetësimin që ua bën atyre që falen. Ajo që e shton çudinë është se në të shumtën e rasteve ato cingërimet (muzikore) kanë hyrë në xhamitë e muslimanëve... *La havle ve la kuvvete ila bilah*, në shtëpitë e Allahut dhe në ruknin (shtyllën) më madhështore (e ai është namazi), ndërsa fjalët e Allahut lexohen ndërkaq muslimanët falen para Zotit të tyre, e më pastaj vijnë këto këngë muzikore dhe e ndërpresin frikërespektin dhe drejtimin kah Allahu, *subhanehu ve teala*, dhe arrijnë deri te shqetësimi, dhe çfarë mëkati arrin ai i cili i ka futur këto këngë dhe cingërimet në shtëpinë e Allahut?!

**Vëlla i dashur!**

Qëllimi i kësaj porosie është përkujtimi dhe jo ndikimi, shënjestrimi dhe jo zgjatja (prolongimi), në paraqitjen e argumenteve të cilat tregojnë për ndalimin e këtij veprimi, dhe se vepruesi është mëkatar i qartë ndaj shtëpisë së Allahut, ndaj namazit të tij dhe ndaj vëllezërve të tij muslimanë.

Është e domosdoshme që ai që falet të hyjë në xhami dhe ta ndërpres lishjen me krijesat dhe të lidhet me namazin dhe Krijuesin e tij.

**Vëlla i dashur!**

Me të vërtetë namazi është vepra më e dobishme për t'i shtuar të mirat dhe për t'i falur mëkatet, edhe përkundër gafletit dhe mosprezencës së frikërespektit

në të kemi ardhur me atë që na pengon nga namazi, e me këtë, edhe më shumë është shtuar ky shqetësim i muslimanëve në xhamitë dhe në namazet e tyre. E ka vaxhib (domosdo) robi t'i ketë frikë Allahut, *subhanehu ve teala*, në këtë namaz dhe ta mundon veten që ta mbyll mobilin e tij para hyrjes së tij në xhami. Sa të pakta janë ato minuta të cilat muslimani i kalon në xhami, në krahasim me orët të cilat i kalon jashta xhamisë në çështjet e kësaj bote? Për ty po i paraqes këto argumente për ndalimin e kësaj çështjeje... Allahu na ndihmoftë!

1. Allahu, *subhanehu ve teala*, ka thënë: "**Edhe ata të cilët zemërojnë padrejtësisht besimtarët dhe besimtarët, ata mbajnë mbi vete krimin e të shpifurit dhe gjunah të qartë**" (El-Ahzab: 58)

Nga parimet e përsëritura është se shembulli vijon nga e përgjithshmja e fjalës dhe jo nga veçantia e shkakut. Dhe nuk ka dyshim se atë që po e bëjnë ata në brendësinë e xhamisë, në përgjithshmërinë e ajetit është padrejtësia që u shkaktohet të tjerëve, Allahu na ruajtë!

2. Transmeton Imam Ahmedi në "Musnedin" e tij dhe Ebu Davudi në "Sunenin" e tij me transmetim të vërtetë nga hadithi i Ebu Seid el-Hudriut, *radijallahu anhu*, se ka thënë: "*Hyri Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, në itikaf në xhami, e ndëgjoi se po lexonin Kur'anin me zë të lartë, e largoi perden e tij e tha: 'A jeni të gjithë duke e lutur Zotin e juaj, pra mos e shetësoni njëri-tjetrin dhe mos e ngreni zërin njëri ndaj tjetrit me lexim', ose ka thënë: "në namaz". E nëse sahabët e kanë ngritur zërrin gjatë leximit të Kur'anit i cili është dhikri më i mirë dhe është fjala e Allahut, e për këtë i ka ndaluar Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, nga leximi me zë të lartë (sepse shqetësojnë njëri-tjetrin), atëherë si është halli me atë që i futë këto cingërrime dhe ring-tone në xhami? Dhe çfarë është mëkati i tij për shqetësimin dhe padrejtësinë që e bën? Pra, ke kujdes, Allahu të ruajtë!*

3. Transmeton Muslimi në Sahih nga hadithi i Ebu Hurejres, *radijallahu anhu*, se Pejgamberi,

salallahu alejhi ve selem, ka thënë: "Nuk e përcjellin melaqet një shoqëri (mexhlis) në të cilën ka qen dhe cingërrimë zërrash".

Po ashtu transmeton nga hadithi i Ebu Hurejres, radijallahu anhu, se Pejgamberi, *salallahu alejhi ve selem*, ka thënë: "Cingërrimat (fishkëllima) janë fyejt e shejtanit". Ka thënë Imam Neveviu (Allahu e mëshiroftë!) në komentimin e "Sahihul Muslimit": "E dëshiruara këtu me melaqet, janë melaqet e mëshirës dhe të istigfarit dhe jo të ruajtjes". E kjo është e qartë se melaqet shqetësohen nga kjo gjë dhe posaçërisht nga këto këngë muzikore. Dhe a ka mundësi që të bashkohen në xhami fjala e Allahut dhe fyelli i shejtanit?! Me të vërtetë është kjo gjë e çuditshme!

E robi musliman le t'i frikohet Zotit të tij, dhe mos futë në shtëpitë e Allahut këto cingërrime dhe këngë muzikore, e të mos i shqetësojnë melaqet e Mëshiruesit e po ashtu edhe robërit e Mëshiruesit e të ngarkohen me mëkat, Allahu na ruajtë!

4. Fetvaja e Komitetit të Përhershëm për Hulumtime Shkencore dhe Fetva, numër 20842 (me datë 2/3/1420 Hixhri ose 1999), kur iu është drejtuar pyetja komitetit me këtë përmbajtje: "Në shumicën e telefonave celularë gjinden këngë dhe cingërrime muzikore, pra a është e lejuar që të vendosen këto këngë në vend të cingërrimës normale?"

Është përgjigjur komiteti se nuk është e lejuar që të përdoren këngët muzikore në telefonat dhe të ngjajshme me to nga mjetet, sepse ndëgjimi i mjeteve muzikore është haram (e ndaluar), siç e argumentojnë këtë argumentet sherijatike, e këtu bën përjashtim përdorimi i cingërrimës normale, Allahu na ndihmoftë!

Kjo fetva e komitetit në ndalimin e këtyre këngëve muzikore është e përgjithshme, e si do të ishte nëse bëhet fjalë për brendësinë e xhamisë ose gjatë faljes së namazit? S'ka dyshim se çështja është edhe më e madhe. E nga fjalët e përparme që u thanë nuk nënkuptohet se zëri normal është haram, por ai është i lejuar nga ata që janë të lejuar.

Ka thënë autori i librit *Bedhel el-Mexhhud* (12/53): "Nuk e përcjellin melaqet një shoqëri (mexhlis) në të cilën ka qen dhe cingërrimë zërrash", dhe kjo përjashtohet nga ajo që është e lejuar. Po ashtu nga fetvaja e Komitetit të Përhershëm nënkuptohet se cingërrima normale për nevojë nuk ka pengesë, por ndalesa bie mbi këngët muzikore në përgjithësi, por cingërrima normale nuk është e lejuar në brendësi të xhamisë dhe në namaz për shkak të shqetësimit dhe dëmit që u përmend më parë.

Në fund e lus Allahun, *subhanehu ve teala*, që të kemi dobi nga ajo që e themi dhe e ndëgjojmë, dhe të na bëj prej atyre që i ndëgjojmë fjalët dhe ta pasojmë më të mirën e tij, që të na furnizoj me sineritet në fjalë dhe vepër, dhe me frikërespekt dhe qetësi shpirtërore e me vepër të mirë, Allahu e din më së miri...

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të dërguarin tonë, Muhammedin, *salallahu alejhi ve selem*, familjen dhe shokët e tij.

Autor: Atik ibn Abdullah El-Uvejrđi  
Përshtati nga arabishtja: Sabahudin Fetahu

## KLUBI STUDENTOR

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:  
Shoqata Qytetare  
Klubi Studentor

e-mail: [penastudentore@hotmail.com](mailto:penastudentore@hotmail.com)

